



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2013

01 janar 2013 - 31 dhjetor 2013

**Shkurt 2014
Prishtinë**

P Ë R M B A J T J A

HYRJE

1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	6
2. Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2013.....	8
3. Aktivitetet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik gjatë vitit 2013.....	40
4. Përmbyllje dhe Rekomandime	59
5. Aneks: Shpenzimet Buxhetore të KRPP-së për vitin 2013.....	61

FJALA E KRYETARIT TË KRPP-së

Të nderuar deputet të Parlamentit të Kosovës,

Kam knaqësinë t'ju dorëzoj Raportin Vjetor mbi aktivitetet e prokurimit publik në Republikën e Kosovës për periudhën Janar-Dhjetor 2013.

Ky raport paraqet në mënyrë analitike të dhënat për kontratat nënshkruara publike, ndarjen e tyre mbi bazën e llojit të procedurave të përdorura nga autoritetet kontraktuese, nivelin e përdorimit të këtyre procedurave, nivelin e konkurrencës brenda tregut publik, si dhe shumë indikator tjerë të rëndësishëm për matjen e performancës së prokurimit publik në Kosovë.

Në raport gjithashtu do të gjeni edhe informacione kualitative për aktivitetet e KRPP-së në planin e monitorimit të sistemit të prokurimit publik, duke përfshirë të gjeturat dhe rekomandimet tona në funksion të përmirësimit të këtij sistemi në përgjithësi.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik vazhdon të kryej me përkushtim maksimal dhe përgjegjësi misionin e saj, duke ofruar bazën ligjore solide në mbështetje të shpenzimit në mënyrë të duhur të parasë publike, si dhe asistencën e nevojshme ligjore për autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomik, organet e rendit duke përfshirë dhe gjykatat, si dhe shoqërinë civile dhe mediat si partner Strategjik të KRPP-së.

Kemi punuar ngushtë me Kuvendin për të zgjeruar kapacitetet tona punuese në dhënjën e informacioneve të duhura mbi shfrytëzimin e parasë publike. Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me Qeverinë dhe aktorët tjerë vendor dhe ndërkombëtar në ndërtimin e një sistemi më të mirë të prokurimit në përgjithësi.

Me zhvillimin dhe përmirësimin e këtij sistemi, një hapsirë të konsiderueshme zënë edhe përkrahja dhe mbështetja që n'a është dhënë nga SIGMA, ZNKE, Banka Botërore etj, për të përmirësuar kornizën ligjore e cila është duke u zbatuar edhe më shumë, dhe kjo rezulton me mbikëqyrje më të fortë.

Për një mbikëqyrje më të suksesëshme kërkohet angazhim dhe përkrahje, si dhe harmonizim të aktiviteteve edhe me akterë tjerë ndër-institucional si Zyra e Auditorit të Përgjithëshëm, Agjensioni Antikorrupsion, NjKE pranë Policisë së Kosovës, Prokurorin, Gjykatat, si dhe akterë të shoqërisë civile, OJQ, dhe media, si dhe një bashkëpunim dhe përkrahje nga nivelet më të larta.

Qasjet dhe metodat e reja si dhe shembujt e suksesit që KRPP-ja ka sjellur këto vite duhet të jenë vision yni në mënyrë që të përmbushim me shumë suksesë misionin tonë të përcaktuar me Ligjin për Prokurim Publik. Në raste të kundërta duhet të merren ndërveprime me vendosmëri dhe të të palëkundurë në realizimin e këtij misioni.

Në rastet kur kemi gjetur dobësi dhe kur n'a është kërkuar kemi dhënë këshilla dhe rekomandime dhe përgjithësisht kjo ka dhënë rezultate të mira. Përcjellim dhe jemi prezent në adresimin e këshillave dhe rekomandimeve tona, poashtu kemi vazhduar të punojmë me menaxhmentet për zbatimin e këtyre këshillave.

Ky raport paraqet sfidat me të cilat duhet të përballemi dhe t'i adresojmë për të përmirësuar sektorin publik. Shpresoj që ky raport t'ju ofrojë një pasqyrë mbi sistemin aktual të prokurimit publik në Kosovë dhe t'ju shërbej sa më mirë në radhë të parë institucioneve që përkujdesën për ligjin në Kosovë, autoriteteve kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe qytetarëve që të jenë prezent dhe të kenë mundësin të përcjellin ndryshimet pozitive që po zhvillohen në këtë sistem në përgjithësi.

I vetëdijshëm për mangësit që mund të këtë raporti, pres me pa durim që ky raport të pasurohet dhe të plotësohet me vrejtitet dhe komentet tuaja!

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

Safet HOXHA

Prishtinë, shkurt 2014

H Y R J E

Duke u bazuar në Nenin 87.2.13 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të Shkurtit të vitit vijues kalendarik

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 01 janar 2013 - 31 dhjetor 2013.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 87.2.12 të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i nëntë me radhë që KRPP-ja përgatit një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2013.

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit. Raporti do të jetë i dobishëm edhe për donatorët e ndryshëm që mendojnë të investojnë në të ardhmen në Kosovë, pasi që, duke u bazuar në të dhënat e raportit, mund të konstatohet se 87.86% e buxhetit për prokurime publike në Kosovë gjatë vitit 2013 janë shpenzuar përmes procedurës së hapur, që njihet si procedura më transparente në prokurimin publik, dhe vetëm 5.60% janë shpenzuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

1. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgjegjësinë kryesore për zhvillimin dhe funksionimin e përgjithshëm të rregullave të prokurimit publik dhe të sistemit të prokurimit publik të Kosovës përmes ushtrimit të autoritetit, kompetencave, funksioneve dhe përgjegjësi të cilat i janë dhënë shprehimisht me këtë ligj.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgjegjësinë dhe autorizimin për:

- ✚ të publikoi në web faqen zyrtare të gjitha llojet e njoftimeve për kontratë që i dergojn autoritëtrt kontraktuese;
- ✚ tu ofroj opinione autoriteteve kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave;
- ✚ të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të këtij ligji nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të këtij ligji; me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në këtë ligj si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim;
- ✚ të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas këtij ligji në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- ✚ të përforcojë vetëdijen ne mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij;
- ✚ t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- ✚ të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim te vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;

- ✚ të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
- ✚ për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të shkurtit të vitit vijues kalendarik;
- ✚ të mbështesë IKAP dhe autoritetet tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar arritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë kompetence në radhët e zyrtarëve të prokurimit dhe profesionistëve të tjerë të prokurimit për zbatimin e praktikave të shëndosha të prokurimit dhe për respektimin e këtij ligji;
- ✚ të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;
- ✚ të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.
- ✚ të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik përbëhet prej tre anëtarëve. Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat prej pesë (5) vjetësh., të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

2. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2013

Duke u bazuar në Nenin 87 pika .2.18 të Ligjit për Prokurim Publik, Nr. 04/L-042, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të përgatisë dhe të mbajë një listë të plotë të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë, të cilat janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik. Gjatë vitit 2013 në Kosovë janë evidentuar 173 autoritete kontraktuese.

Nga gjithsejt 173 autoritete kontraktuese të evidentuara në fund të vitit 2013, 167 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore. Autoriteti kontraktuese Kompania Rajonale e Mbeturinave "HIGJIENA" Gjilan dhe OJQ-ja "Qendra Rajonale për Mjedisin për Evropën Qendrore dhe Lindore" janë deklaruar se nuk kan kryer prokurime gjatë vitit 2013 konform LPP, Nr. 04/L-042. Katër autoritete kontraktuese fare nuk i kanë dërguar raportet vjetore. Autoritetet kontraktuese, të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore, janë tri komuna nga pjesa veriore e Kosovës si Komuna e Zveqanit, e Zubin Potokut, e Leposaviqit si dhe Trepça (në pjesën veriore).

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2014, i kanë dërguar në mënyrë elektronike, departamenti i TI-së dhe Statistika i KRPP-së ka përgatitur Raportin përmbledhës vjetor për të gjitha prokurimet publike të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2013.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2013 në tërë Kosovën janë nënshkruar 12551 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kriterëve të shpërblyer me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2013 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

2.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA			
Autoritetet kontraktuese:	Gjatë vitit 2011	Gjatë vitit 2012	Gjatë vitit 2013 ¹
Qeveritare	9305	9112	9682
Kompani publike	3001	2910	2839
Tjera/OJQ	4	23	30
Gjithsej:	12310	12045	12551


Tabela 1

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Analizën e kontratave të nënshkruara po e fillojmë me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – Qeveritare, Kompani publike dhe të tjera-OJQ. Dihet mirëfilli se kjo ndarje nuk e paraqet një pasqyrë reale të financimit, pasi që një numër i konsiderueshëm i kompanive publike në Kosovë financohen ende nga BKK-ja. Sido që të jetë, ne do të mundohemi, duke u bazuar në këtë ndarje, ta pasqyrojmë numrin e kontratave të nënshkruara në tabelën nr. 1 dhe në grafikonin nr. 1 gjatë tri viteve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.

Viti 2013 është viti i dytë që janë përdorur Kontratat Kornizë nga autoritetet kontraktuese. Pra tani kanë filluar të përdoren këto lloje të kontratave thuaja nga të gjithë, sidomos vrehet një përdorim i theksuar te autoritetet kontraktuese si Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A, te të gjitha ministrit , komunat dhe agjencionet . Vlera e këtyre kontratave është e pamundur të saktësohet pasi që kryesisht këto kontrata janë nënshkruar me çmim për njësi, por mund të konstatojmë se vlera e tyre është e lartë pasi që kemi të bëjmë kryesisht me furnizime si derivatet dhe sherbime si sigurime të objekteve, mirmbajtje të objekteve etj. të cilat arrijnë një shumë të konsideruar në prokurimet e zhvilluara në Kosovë.

¹ Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 266 anekskontrata.



Grafikoni 1

2.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITEVE 2011,2012 DHE 2013 (€)			
Autoritetet kontraktuese:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013 ²
Qeveritare	284,714,229.60	318,593,149.16	348,631,297.84
Kompani publike	267.260.689,03	188,565,175.83	93,626,952.26
Tjera	175.849,56	704,978.90	1,923,149.00
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga MI ³	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92

Tabela 2


² Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera e anekskontratave në vlerë prej 5,469,844.25€

³ Kontrata afatgjate për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga Ministria e Infrastruktës.

Siq mund të vrehim nga tabela 2 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë tri viteve të fundit. Kontratën për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare, e kemi paraqit si kontratë të veçant pasi që kontrata në fjalë është kontratë me vlerë të madhe dhe sipas Ministris së Infrastruktures kjo kontratë është afatëgjate dhe vlera e parashikuar për vitin 2010 ishte 106,883,295.92€, për vitin 2011 arrin 236.165.999,52€, për vitin 2012 është 235,379,330.33€, dhe vlera e parashikuar gjatë vitit 2013 ishte 210,549,681.92€ të cilën po e pasqyrojm në grafikonin 2 .




Grafikoni 2



Grafikoni 3

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lartë në tabelën nr.2 dhe grafikonin nr.3 pasqyrohet vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë tri viteve të fundit.

Grafikoni nr.4 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Organizatat buxhetore - qeveritare marrin pjesë me 78.49%, kompanitë publike me 21.08%, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0.43% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.




Grafikoni 4

2.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (€)			
Burimet e financimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013
Të hyrat vetanake ⁴	222.248.360,71	188,565,175.83	93,991,324.00
Buxheti i Kons. i Kosovës	323,841,023.84	314,128,078.32	343,489,659.92
Donacione	6.061.383,65	5,170,049.74	6,700,415.18
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga MI.	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92

Tabela 3


Në tabelën nr. 3 dhe grafikun nr. 4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetanake vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 është 93,991,324.00€. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 343,489,659.92€, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 6,700,415.18€.



Grafikoni 4

⁴ Të hyrat vetanake paraqesin të hyrat e kompanive publike.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikun nr.5 ku të Hyrat vetanake të kompanive marrin pjesë me 21.17%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 77.33 %, kurse nga donacionet me 1.50 %.



Grafikoni 5

2.4. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT (€)			
Lloji i prokurimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013
Furnizim	308,709,092.99	193,136,785.94	138,220,130.76
Shërbime⁵	64,305,010.99	99,274,281.42	45,351,704.76
Konkurs i projektimit	2,158,906.03	1,207,952.71	734,756.75
Punë	176,977,758.19	214,244,283.82	259,874,806.83
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontr. për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga MI.	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92

Tabela 4

⁵ Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.


Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 4 dhe grafikonin nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime gjatë vitit 2013 arrin në 138,220,130.76€. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 45,351,704.76€, dhe vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 734,756.75€.

Ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 259,874,806.83€, dhe kësaj vlere nëse ja shtojm edhe vlerën e Autostradës Morinë- Merdar në shumë e planifikuar për vitin 2013, prej 210,549,681.92€, vlera e kontratave për punë gjatë vitit 2013 arrinë në 470,424,488.75€.




Grafikoni 6

Në vazhdim në grafikonin 6a. po paraqesim vlerën e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit, ku vlerës së kontratave për punë ju shtohet edhe vlera e planifikuar e autostradës gjatë tri viteve në vijim, ku na pasqyron gjendje reale të prokurimeve sipas llojeve të tyre, dhe ku prokurimet për punë janë shumë më të larta.




Grafikoni 6a



Grafikoni 7

Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 31.12%. Kontratat për shërbime me 10.20%, kontratat për konkurse të projektimit me 0.17 %, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 58.51% .

Derisa në grafikun nr.8 pasqyrohet struktura, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2012, ku vlerës së kontratave për punë i shtohet vlera e Autostradës Morinë-Merdare e paraparë për vitin 2013 prej 210,549,681.92€ dhe vlera e gjithmbarshme e kontratave për punë gjatë vitit 2013 arrijnë 470,424,488.75€ apo 71.85% në vlerën e gjithmbarshme të kontratave të nënshkruara. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 21.11%. Kontratat për shërbime me 6.93%, kontratat për konkurse të projektimit me 0.11%.




Grafikoni 8

2.5. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT (€)			
Lloji i vlerës së prokurimit:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013
Vlerë e madhe	362,942,453.16	306,168,146.54	247,402,583.69
Vlerë e mesme	163,603,179.07	173,773,476.01	167,549,046.07
Vlerë e vogël	23,111,720.20	25,531,901.39	26,706,716.04
Vlerë minimale	2,493,415.77	2,389,779.95	2,523,053.30
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga MI.	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92


Tabela 5

Kontratat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave, në tabelën nr. 5 dhe në grafikun nr.9, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 është 247,402,583.69€.



Grafikoni 9

Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 167,549,046.07€, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 26,706,716.04€. Vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 2,523,053.30€.



Grafikoni 10

Në bazë të grafikoni nr.10, vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013, është 55.70%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 37.72%. Kontratat me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 6.01%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0.57%.

2.6. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT (€)			
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013
Procedurë e hapur	457,187,278.28	426,605,842.24	390,277,502.17
Procedurë e kufizuar	7,450,000.80	0.00	0.00
Konkurs projektimi	2,158,906.02	1,193,137.72	734,756.75
E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	26,600,075.83	507,289.75	75,093.31
E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	34,295,214.22	53,035,295.31	24,902,026.04
Kuotimi i çmimeve	21,971,811.73	24,124,914.80	25,656,613.16
Procedurë për vlerë minimale	2,487,481.32	2,396,824.07	2,535,407.67
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontrata për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga MI.	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92


Tabela 6

Analiza e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën nr. 6 dhe në grafikun nr.11, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2013 është 390,277,502.17€. Sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2013 autoritetet kontraktuese nuk kanë kryer prokurime.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2013, është 734,756.75€, derisa vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës, gjatë vitit 2013, është 75,093.31€. Kurse sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është 24,902,026.04€ dhe vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2013, është 25,656,613.16€.


Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë vitit 2013, është 2,535,407.67€.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit gjatë viteve 2011,2012 dhe 2013



Grafikoni 11

Gjithësejt - Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 sipas procedurave të prokurimit




Grafikoni 12

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2013, në grafikonin nr. 12, na tregon se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara është 87.86%, e cila është nga procedurat e përdorura më së shumti dhe e njohur si procedura më transparente.

Gjithashtu edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës është 0.02%. Dhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës gjatë vitit 2013 ka shënuar një rënje. Derisa gjatë vitit 2008 kjo pjesëmarrje ishte 16.07%, gjatë vitit 2009 në 10.83%, dhe gjatë vitit 2010 kjo pjesëmarrje ka rënë në 7.02% derisa gjatë vitit 2011 ishte 6,21%, dhe gjatë vitit 2013 përdorimi i kësaj procedure është vetëm 5.60%.


Pjesëmarrja e procedurave sipas kufizimit të çmimeve është 5.78% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0.57%, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0.17% në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2013.

Prandaj, mund të konstatojmë se përdorimi i procedurës së hapur ka trend në rritje, dhe përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës është me trend në zvoglim, dhe këta pra janë indikatorë mjaftë pozitiv dhe shpresëdhënës për sistemin e prokurimit publik.




Grafikoni 13

Grafikoni 13 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat buxhetore apo Qeveritare. Derisa grafikoni 14 pasqyron përdorimin e procedurave të prokurimit te Kompanit Publike dhe grafikoni 15 paraqet përdorimin e procedurave të prokurimit te organizatat tjera- OJQ-të.



Grafikoni 14




Grafikoni 15

2.7. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2013 SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT 2013 (€)								
Lloji prokurimit	Procedurat e prokurimit							Gjithsej:
	E hapur	E kufizuar	Konkurs projektimi	E negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Kuotim i çmimeve	Procedur vlera minimale	
Furnizim	108,170,420.36	-	-	30,592.00	14,749,040.89	13,364,659.25	1,905,418.26	138,220,130.76
Shërbime	31,383,802.00	-	-	-	5,411,201.88	7,958,898.27	597,802.61	45,351,704.76
Konkurs projektim	-	-	734,756.75	-	-	-	-	734,756.75
Punë	250,723,279.81	-	-	44,501.31	4,741,783.27	4,333,055.64	32,186.80	259,874,806.83
Gjithsej	390,277,502.17	-	734,756.75	75,093.31	24,902,026.04	25,656,613.16	2,535,407.67	444,181,399.10
Vrejtje:Pjesa e Kontrates për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga Ministria e Infrastrukturës								210,549,681.92

Tabela 7

Në tabelën nr. 7 dhe grafikun nr. 16 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe ndërthurjen e tyre me vlera të kontratave sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2013. Këtu, pra, pasqyrohet secili lloj i prokurimit ndaj procedurës së zbatuar të prokurimit.




Grafikoni 16

2.8. KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKSKONTRATAT GJATË VITIT 2013

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA DHE ANEKSKONTRATAVE GJATË VITIT 2012 DHE 2013 (€)				
Kontratat:	Vlera 2012 (€)	Pjesmarrja 2012 %	Vlera 2013 (€)	Pjesmarrja 2013 %
Kontratat e nënshkruara	504,059,800.76	99.25	438,711,554.85	98.77
Anekskontratat	3,803,503.13	0.75	5,469,844.25	1.23
Gjithsej :	507,863,303.89	100.00	444,181,399.10	100.00
Kontrata e Autostradës Morinë-Merdare nga MI.	235,379,330.33		210,549,681.92	

Tabela 8

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 dhe aneks kontratave



Grafikoni 16a


Siç shihet nga tabela e mësipërme nr.8 dhe grafikoni nr.16a vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 është 438,711,554.85€, me një pjesëmarrje prej 98.77% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 444,181,399.10€, kurse vlera e aneks kontratave arrin në 5,469,844.25€, apo me pjesëmarrje 1.23% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 444,181,399.10€ .

2.9. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDORË DHE JOVENDORË

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA OE VENDORË – JOVENDORË GJATË VITIT 2011,2012 DHE 2013 (€)			
Operatorët ekonomik:	Vlera e kontratave 2011	Vlera e kontratave 2012	Vlera e kontratave 2013
Operatorët vendor	411,401,311.14	417,611,791.96	412,984,556.80
Operatorët jovendor	140,749,457.06	90,251,511.93	31,196,842.30
Gjithsej :	552,150,768.20	507,863,303.89	444,181,399.10
Kontrata Autostrada Morinë-Merdare nga MI.	236.165.999,52	235,379,330.33	210,549,681.92

Tabela 9

Nga analiza e bërë vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operator ekonomik vendor dhe jovendor, në tabelën 9, grafikunin 17, del se vlera e kontratave të dhëna operatorëve vendor është 412,984,556.80€, kurse pjesëmarrja në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 është 92.98%. Derisa vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013 nga operatorët jovendor është 31,196,842.30€ dhe me pjesëmarrje prej 7.02% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013.



Grafikoni 17

2.10. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR PËR PUBLIKIM

VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS AFATIT KOHOR TË PUBLIKIMIT GJATË VITIT 2012 DHE 2013 (€)				
Afatet e publikimit:	Vlera e kontratave 2012	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2013	Pjesëmarrja %
Afate normale kohore	443,271,212.00	87.28	410,588,831.14	92.44
Shkurtim i afatit	64,592,091.89	12.72	33,592,567.96	7.56
Gjithsej :	507,863,303.89	100.00	444,181,399.10	100.00
Kontrata Autostrada Morinë-Merdare nga MI.	235,379,330.33		210,549,681.92	

Tabela 10

Të dhënat në tabelën nr. 10, vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore të publikuara është 410,588,831.14€ dhe me pjesëmarrje prej 92.44% në vlerën e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara të publikuara me afat të shkurtuar arrin në 33,592,567.96€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 7.56% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013.

2.11. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE


VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE GJATË VITIT 2012 DHE 2013 (€)				
Kriteret për dhënie kontrate:	Vlera e kontratave 2012	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2013	Pjesëmarrja (%)
Çmimi më i ulët	459,473,908.11	90.47	433,578,318.30	97.61
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	48,389,395.78	9.53	10,603,080.80	2.39
Gjithsej :	507,863,303.89	100.00	444,181,399.10	100.00
Kontrata Autostrada Morinë-Merdare nga MI.	235,379,330.33		210,549,681.92	

Tabela 11

Siç shihet në tabelën nr. 11 vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, sipas kriterit për dhënie çmimi më i ulët, është 433,578,318.30€, me pjesëmarrje prej 97.61% në vlerën e gjithëmbarshtëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Ndërkaq, vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm arrin në 10,603,080.80€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 2.39% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2013. Siq mund të shohim nga tabela nr. 11 pjesmarrja e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm gjatë vitit 2011 ishte 15,46 kurse gjatë vitit 2012 kemi pra një zvoglim të dukshëm të përdorimit të këtij nënkriteri në 9,53%, dhe duke rënë në 2.39% gjatë vitit 2013.


2.12. NUMRI MESATAR I OFERTUESVE QË KAN KONKURUAR PËR NJË TENDER GJATË VITIT 2013

Grafikoni nr. 18 na pasqyron numrin mesatar të ofertuesve që kan konkuruar për një tender apo prokurim në Kosovë gjatë viteve 2008 deri 2013. Mesatarja gjatë këtyre viteve delë se për një tender kanë ofertuar 5.5 operator ekonomik. Pra, mund të konstatojm se konkurenca në prokurimin publik është mjaftë e mirë.



Grafikoni 18.

2.12. VLERE E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITEVE 2007-2013




Grafikoni 18.a

Grafikoni nr. 18.a na paraqet diagramin e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2007 deri 2013 duke përfshi edhe pjesën për kontratë të autostradës Morin – Merdar.

2.13. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË RAPORT ME BPV NË KOSOVË GJATË VITIT 2013

Vlera e përgjithshme e prokurimeve publike gjatë vitit 2013, është 444,181,399.10€, gjë që paraqet 8.63% të BPV (bruto produkti vendor në vitin 2013 në Kosovë ishte 5,149,000,000.00€.)⁶. Grafikoni nr. 19 në vazhdim paraqet këtë pjesëmarrje.


Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara në Bruto Produktin Vendor gjatë vitit 2013



Grafikoni 19

⁶ Burimi : IMF Country Report No. 13/379; Republic of Kosovo - Fifth Review under the Stand-by Arrangement, December 2013 (Vlerësim).

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara (duke e shtuar edhe pjesën e autostrades të parashikuar për vitin 2013) në Bruto Produktin Vendor



Grafikoni 20

Në grafikonin nr. 20 pasqyrohet pjesëmarrja e kontratave të nënshkruara bashkë me vlerën e parashikuar për vitin 2013 të autostrades Morinë – Merdar, prej 654,731,081.02€ në BPV e që ishte 5,149,000,000.00€.

2.14 NUMRI DHE VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2013

NR	AUTORITETET KONTRAKTUESE	NR I KONT RATA VE ⁷	VLERA E KONTRATAVE (€)	PJESËMAR RJA (%)
1	Administrata Tatimore e Kosovë	72	1,077,139.13	0.24
2	Aeroporti Nderkombetar i Prishtinës Adem Jashari	26	492,274.56	0.11
3	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	23	66,656.47	0.02
4	Agjencia e Statistikave të Kosovës	8	26,906.00	0.01
5	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	56	976,251.96	0.22
6	Agjencia Kadastrale e Kosovës	6	7,054.21	0.00
7	Agjencia Kosovare e Privatizimit	50	1,719,265.91	0.39
8	Agjencia Kundër Korrupsionit	28	69,876.93	0.02
9	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar	4	46,830.19	0.01
10	Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM	7	10,183.10	0.00
11	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	14	28,420.61	0.01
12	Agjencia Pyjore e Kosovës	21	1,034,588.60	0.23
13	Agjencia qendrore për mbrojtjen e të dhënave personale	20	78,544.48	0.02
14	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	25	57,431.72	0.01
15	Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale	26	236,506.16	0.05
16	Agjencioni Kosovar i Pronës	83	338,054.31	0.08
17	Agjencioni për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës	7	811,530.02	0.18
18	Agjencioni Qendror i Prokurimit	6	38,714.44	0.01
19	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	47	1,358,219.87	0.31
20	Akademija e Shkencave dhe Arteve	37	138,930.26	0.03
21	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	17	65,242.68	0.01
22	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	8	17,253.02	0.00
23	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	12	49,286.81	0.01
24	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	16	209,763.29	0.05
25	Biblioteka Komëtare dhe Universitare e Kosovës	57	130,461.14	0.03
26	Caritas Switzerland, Prizren Office, Kosova	1	886,693.37	0.20
27	Community Development Fund/CDF	1	1,310.00	0.00
28	Community Development Initiatives/ CDI	8	781,421.99	0.18
29	Dogana e Kosovës	48	1,229,896.78	0.28
30	Drini i Bardhë Pejë	5	258,209.30	0.06
31	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	27	364,371.74	0.08
32	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	22	140,944.25	0.03
33	Hortikultura Prishtinë	27	310,604.39	0.07
34	Infrakos Sh A	156	557,924.92	0.13

⁷ Kontratat e nënshkruara përfshijnë të gjitha llojet e kontratave, pra edhe kontratat me vlerë minimale

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

35	Inspektorati Policor i Kosovës	23	155,071.51	0.03
36	Institucioni i Avokatit te Popullit	23	88,058.10	0.02
37	Instituti Albanologjik Prishtinë	10	60,776.90	0.01
38	Instituti Gjyqësor i Kosovës	24	210,015.35	0.05
39	Instituti i Mjekësisë së Punës Kosovë-Gjakovë	32	135,429.11	0.03
40	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës	25	343,491.03	0.08
41	Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike të Kosovës-Dega Ferizaj	4	6,800.50	0.00
42	K Deçan	63	2,392,844.80	0.54
43	K Dragash	196	1,855,306.87	0.42
44	K Drenas	220	3,847,531.79	0.87
45	K Ferizaj	250	9,297,893.65	2.09
46	K Fushë Kosovë	138	2,301,618.33	0.52
47	K Gjakovë	90	6,379,524.32	1.44
48	K Gjilan	144	3,142,003.24	0.71
49	K Graçanica	82	2,842,251.90	0.64
50	K Hani i Elezit	70	711,505.63	0.16
51	K Istog	132	2,709,042.63	0.61
52	K Junik	47	893,069.73	0.20
53	K Kaçanik	102	1,934,223.48	0.44
54	K Kamenicë	76	2,222,713.51	0.50
55	K Klinë	120	3,774,248.26	0.85
56	K Klllokot	22	380,824.04	0.09
57	K Lipjan	205	7,201,368.47	1.62
58	K Malisheve	255	4,059,637.49	0.91
59	K Mamushe	31	205,648.75	0.05
60	K Mitrovice	268	3,404,542.48	0.77
61	K Novo Berd	91	902,881.36	0.20
62	K Obiliq	70	1,640,877.54	0.37
63	K Partesh	4	835,749.20	0.19
64	K Peje	231	6,313,213.19	1.42
65	K Podujeve	210	8,177,626.09	1.84
66	K Prishtine	275	25,179,784.15	5.67
67	K Prizren	441	13,096,982.58	2.95
68	K Rahovec	133	7,151,605.13	1.61
69	K Ranillug	23	178,650.97	0.04
70	K Shterpc	70	2,579,749.46	0.58
71	K Shtime	93	3,712,793.43	0.84
72	K Skenderaj	64	7,767,974.90	1.75
73	K Suhareke	236	6,469,798.51	1.46
74	K Viti	75	3,180,940.57	0.72
75	K Vushtrri	239	4,469,997.61	1.01
76	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë	14	12,357.60	0.00

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

77	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	39	502,074.59	0.11
78	Komisioni i Pavarur per Media	30	379,051.29	0.09
79	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	66	1,466,655.56	0.33
80	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	19	48,188.49	0.01
81	Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove	26	842,661.80	0.19
82	Kompania Rexhionale për Menaxhim të Hedhurinave "Uniteti" Mitrovicë	20	134,815.30	0.03
83	Kompanija e Ujesjellsit Rajonal Hidrodrini sh.a.Pejë	36	479,654.55	0.11
84	Kompanija e Ujesjellsit Rajonal"Prishtina"	109	1,922,948.96	0.43
85	Kompanija Ujësjiellsi Regjional " Mitrovica"Sh. A. Mitrovicë	24	225,591.15	0.05
86	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	864	50,835,875.61	11.44
87	KOSTT sh.a	182	8,512,308.53	1.92
88	KRM Ekoregjioni-Prizren	8	26,083.95	0.01
89	KRM " Pastërtia " Sh.a Ferizaj	15	458,861.92	0.10
90	KRM " Ambienti" - Pejë	31	170,716.77	0.04
91	KRM Çabrati - Gjakovë	14	247,607.20	0.06
92	KRM Pastrimi - Prishtinë	124	356,302.26	0.08
93	KRU "RADONIQI" Sh.A. Gjakovë	74	2,295,977.57	0.52
94	KRU "Hidromorava SH A "Gjilan	22	225,490.78	0.05
95	KRU "Radoniqi&Dukagjini" Gjakove	24	121,494.12	0.03
96	KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren	62	2,832,248.64	0.64
97	KRUK "BIFURKACIONI" SH.A	22	107,936.90	0.02
98	Kuvendi i Republikës së Kosovës	63	726,156.39	0.16
99	Masht DANIDA	18	229,272.14	0.05
100	Ministria e Administratës Publike	117	11,703,625.04	2.63
101	Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal	54	627,103.53	0.14
102	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	115	11,882,726.97	2.68
103	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	59	916,881.15	0.21
104	Ministria e Diasporës	66	269153.09	0.06
105	Ministria e Drejtësisë	43	315,102.45	0.07
106	Ministria e Financave	75	417,724.13	0.09
107	Ministria e Forcës së Sigurisë	142	12,598,494.65	2.84
108	Ministria e Infrastruktues	112	62,731,938.80	14.12
109	Ministria e Integritimit European	41	142,066.68	0.03
110	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	97	2,437,920.03	0.55
111	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor	244	8,396,872.22	1.89
112	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	56	2,202,157.40	0.50
113	Ministria e Punëve të Brendshme	87	16,516,817.92	3.72
114	Ministria e Punëve të Jashtme	75	831,077.56	0.19
115	Ministria e Shëndetësisë	157	7,302,882.54	1.64
116	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	122	2,804,594.57	0.63
117	Ministria e Zhvillimit dhe Ekonomis	76	1,075,946.29	0.24

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

118	Ministria per Komunitete dhe Kthim	67	766,161.92	0.17
119	Ndërmarrja Publike Banesore Prishtinë	8	1,813,679.19	0.41
120	Ngrohtorja e Qytetit SHA Gjakovë	3	1,428.75	0.00
121	NH Iber Lepenc	54	1,798,806.75	0.40
122	Njesia e Inteligjencës Financiare e Kosovës	11	101,327.90	0.02
123	NP "TERMOKOS" sh.a.	27	234,497.13	0.05
124	Organi Shqyrtues i Prokurimit	18	15,642.06	0.00
125	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	4	16,532.75	0.00
126	Policia e Kosovës	265	4,657,984.42	1.05
127	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosoves SH.A	277	8,731,002.51	1.97
128	Posta e Kosovës Sh.A.	100	2,519,692.30	0.57
129	Prokurori i Shtetit	22	228,439.84	0.05
130	Qendra e Kosoves per Transfuzionin e gjakut Prishtine	33	1,103,088.71	0.25
131	Qendra e Mjeksis Urgjente	20	77,390.64	0.02
132	Qendra e Studentëve	41	1,674,674.08	0.38
133	Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës	48	315,496.79	0.07
134	Qendra Klinike Univeristare e Kosovës	219	8,716,110.87	1.96
135	Qendra kryesore e mjeksis familjare Prishtinë	50	164,311.79	0.04
136	Radio Televizioni i Kosovës	208	2,024,510.99	0.46
137	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	79	3,216,224.73	0.72
138	Sekretariati-Këshilli i Sigurisë së Kosovës	10	30,480.57	0.01
139	Shërbimet e Shëndetit Mendor - Prizren	26	39,829.69	0.01
140	Sherbimet e Shendetit Mendor Gjakovë	17	54,371.39	0.01
141	Sherbimet e Shendetit Mendor Gjilan	27	48,229.64	0.01
142	Sherbimi i shendetit mendor - Pejë	16	45,702.29	0.01
143	Sherbimi i Shendetit Mendor Ferizaj	10	61,695.84	0.01
144	Sherbimi i Shendetit Mendor- Mitrovicë	17	47,422.45	0.01
145	Sherbimi Korrektues i Kosoves	11	29,060.56	0.01
146	Sherbimi Korrektues i Kosoves	29	3,004,143.45	0.68
147	Sherbimi Profesional I Shendetit Mendor-Shtime	12	60,220.39	0.01
148	Spitali i Vushtrisë	63	469,492.39	0.11
149	Spitali Rajonal Ferizaj	39	581,218.13	0.13
150	Spitali Regjional Gjakovë	52	1,221,802.61	0.28
151	Spitali Regjional Gjilan	92	1,253,266.65	0.28
152	Spitali Regjional Mitrovicë	88	973,738.97	0.22
153	Spitali Regjional Pejë	89	1,551,802.03	0.35
154	Spitali Regjional Prizren	107	1,094,373.43	0.25
155	Trainkos sh.a	95	1,600,771.14	0.36
156	Trepça Ndërmarrje në Administrimtë AKP-ës	196	3,486,974.32	0.79
157	Universiteti I Mitrovices	9	39,648.31	0.01
158	Universiteti i Pejes	30	110,759.33	0.02
159	Universiteti i Prizrenit	117	5,344,646.69	1.20
160	Universiteti i Prizrenit	62	1,011,652.78	0.23

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

161	World University Service (WUS) Kosova	2	24,451.50	0.01
162	Zyra e Auditorit te Pergjithshem	57	833,301.31	0.19
163	Zyra e Auditorit te Pergjithshem	45	199,327.17	0.04
164	Zyra e Kryeministrit	60	248,896.48	0.06
165	Zyra e Presidentit	53	251,379.24	0.06
166	Zyra e Rregullatorit për Energji	19	93,299.16	0.02
167	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina	25	28,190.81	0.01
	Gjithsejt:	12551	444,181,399.10	100.00
Pjesa e Kontratës për ndërtimin e Autostradës Morinë-Merdare nga Ministria e Infrastrukturës gjatë vitit 2013			210,549,681.92	

2.15 KONTRATAT E NËNSHKRUARA ME VLERË MBI 1,500,000.00 € NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2013

AUTORITETET KONTRAKTUESE:		PROCEDURA E PËRDORUR	PËRSHKRIMI I KONTRATËS	VLERA E KONT.(€)
1	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	RIPARIMI OSE BLERJA E PAJISJEVE TË REJA NË DEPONINË E SEPERACIONIT NË TC KOSOVA B	9,193,854.54
2	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	Riparimi Kapital i Njesisë A4, TC Kosova A ('KEK') Lot 2: Riparimi Kapital i Kaldajës dhe Nxemsave të Ajrit	8,142,253.00
3	Ministria e Punëve të Brendshme	Procedurë e Hapur	Furnizim me letërnjoftime elektronike	7,879,043.00
4	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	Blerja e librave prej klasës 1-9	7,280,769.81
5	Ministria e Punëve të Brendshme	Procedurë e Hapur	Furnizimi me pasaporta elektronike	6,631,896.00
6	Ministria e Administratës Publike	Procedurë e Hapur	Ndërtimi i Qendrës së paraburgimit në Prishtinë	5,745,973.96
7	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi i Rrugës M9-segmenti:Gjurgjicë-Kijevë, Sektori D, Lot 3 (Mleçan-Kijevë).	5,643,472.22

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

8	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi I rruges nacionale M9- Segmenti Arllat - Kijevë sektori D	5,209,035.33
9	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi I rruges nacionale M2- Segmenti Milloshevë - Vushtri Lloti 2 Milloshevë-Babimoc -	4,869,943.01
10	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi I rruges nacionale M9 Segmenti Arllat Kijevë sektori D llot 2	4,478,135.93
11	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	Furnizim me Energji emergjente dhe day ahead për periudhën Mars – Dhjetor 2013	4,200,000.00
12	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi I rruges nacionale M2- Segmenti Milloshevë - Vushtri Lloti 3 Babimost - Lumi I Madh	3,825,397.61
13	Universiteti i Prishtinës	Procedurë e Hapur	Ndertimi I FBV	3,443,842.51
14	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi i Rrugëve Ibrahim Ademi dhe Driton Islami	3,393,701.57
15	Qendra Klinike Univeristare e Kosovës	Procedurë e Hapur	Patsrimi i hapsirave te brendeshme te QKUK-se	3,286,211.00
16	K Lipjan	Procedurë e Hapur	Asfaltimi I rruges me kater korsi	2,888,108.61
17	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	Furnizim me Energji emergjente dhe day ahead për periudhën Mars – Dhjetor 2013	2,800,000.00
18	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi I rruges nacionale M2 Segmenti Milloshevë Vushtri Llot 1	2,263,939.45
19	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	E negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	FURNIZIM ME SHTEPIZEN E JASHTME TE TURBINES SE PRESIONIT TE LARTE NE BLOKUN B1	2,250,000.00
20	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Ndërtimi i Rrugës Mushtisht-Budakovë-Jezerc-Ferizaj, Lloti 2	1,999,999.99
21	KOSTT sh.a	Procedurë e Hapur	LOT 1: Rehabilitimi i Stabilimenteve te TL ne NS 110/10kV Gjakova 2	1,973,912.00


Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

22	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Ndërtimi i Rrugës Pejë-Tërstenik	1,937,283.19
23	Ministria e Infrastruktures	Procedurë e Hapur	Zgjerimi i Rrugës në Hyrje të Qytetit të Pejës	1,932,075.02
24	Ministria e Administratës Publike	Procedurë e Hapur	Punet ne rregullimin e parterit me heliodrom,portes hyrese si dhe kompletimi I puneve ndertimore instaluese ne objektin e MFSK-se	1,931,349.08
25	K Skenderaj	Procedurë e Hapur	Ndertimi I shkolles se mesme " Hamez Jashari " ne Skenderaj	1,895,607.62
26	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	Procedurë e Hapur	Ndertimi I objektit te Gjykates Themelore ne Ferizaj	1,894,843.84
27	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	Furnizim me Energji emergjente dhe day ahead për periudhën Janar – Dhjetor 2013/ Rivlersim/	1,800,000.00
28	K Ferizaj	Procedurë e Hapur	Ndertimi me kater korsi I rr."Rexhep Bislimi"- projekt dyvjeqar	1,798,687.72
29	KOSTT sh.a	Procedurë e Hapur	LOT 2: Rehabilitimi i Stabilimenteve te TL ne NS 110/10kV Prizreni 3	1,796,234.47
30	KOSTT sh.a	Procedurë e Hapur	Renovimi i Fasades se objektit te KOSTT-it me punet percjellese	1,789,427.83
31	Ndërmarrja Publike Banesore Prishtinë	Procedurë e Hapur	Ndertimi I Lokaleve Afariste ne Qytezen Pejton	1,779,759.94
32	KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren	Procedurë e Hapur	Furnizim me gypa HD-PE100	1,619,445.00
33	Korporata Energjetike e Kosovës KEK Sh.A.	Procedurë e Hapur	FURNIZIM ME PJESË REZERVE PËR MEKANIZIMIN E RËNDË - IVECO	1,600,188.81

3. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK


Duke u bazuar në neni 42 të LPP të Kosovës Nr. 04/L-042, çdo autoritet kontraktues duhet të bëjë publikimin e njoftimeve për kontratë të të gjitha llojeve sa herë që përdor procedura të hapura, të kufizuara, ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës në ueb faqen zyrtare të KRPP-së: <http://krpp.rks-gov.net>

Departamenti për Teknologji Informativ dhe Statistika ka filluar t'i publikojë Njoftimet për kontratë në ueb-faqen elektronike prej muajit korrik 2007, duke vazhduar edhe gjatë vitit 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013 të cilat po i paraqesim në grafikonin tri vitet e fundit në vazhdim.




Grafikoni 21

Duke e analizuar grafikonin nr. 21 konstatohet se publikimi i njoftimeve për kontratë gjatë vitit 2013 është 5256, njoftimet për dhënie të kontratës janë rritur në 6919. Si shihet numri i njoftimeve për dhënie ka një rritje në krahasim me vitet paraprake, ndërsa në këtë rritje ka ndikuar publikimi i njoftimeve për dhënie të kontratave me vlerë të vogël – kuotimi i çmimeve. Derisa njoftimet për anulim janë të përafërta me vitin 2012, pra gjatë vitit 2013 janë publikuar 1882 njoftim anulime.



Grafikoni 22

Në grafikonin nr. 22 pasqyrohet struktura e numrit të njoftimeve të publikuara gjatë vitit 2013. Siq shihet numrin e njoftimeve për dhënie është më i madh, pasi që publikimi i njoftimit për kontratë të vlerave të vogla – Kuotimeve nuk është obligim ligjor, derisa dhënja e tyre po, andaj kjo ndikon që njoftimet për dhënie janë gjithëherë më të mëdha.




Grafikoni 23

Grafikoni nr. 23 pasqyron strukturën apo pjesëmarrjen e arsyeve të anulimit të tenderëve gjatë vitit 2013.

Më poshtë në tabelën nr. 12 dhe grafikonin nr. 23a tregohen disa statistika të përgjithshme mbi përdorimin dhe vizitorët e ueb faqes së KRPP-së gjatë vitit 2013:

NUMRI I VIZITORVE TË UEB FAQES SË KRPP-SË GJATË VITIT 2013	
	Ditorë/mesatar
Nrumri i vizitorëve	8 400
Nrumri i shfletimit të njoftimeve	12 560
Nrumri i shkarkimit të njoftimeve	3 360
Nrumri i shfletimit të legjislacionit	85

Tabela 12



Grafikoni 23a

* * *

KRPP-ja përmes Departamentit të Rregullave, nga 1 janari e deri më 31 dhjetor të vitit 2013, kanë arrit të ofrojnë një numër të konsiderueshëm të këshillave profesionale përmes arkivës së KRPP-së, adresës zyrtare elektronike “ info.krpp ”, si dhe përmes telefonit, si në vijim:

PËRGJIGJET E DEP. RREGULLAVE GJATË VITIT 2013	
Përgjigjet e shprehura në numër	Mënyra e dhënies së përgjigjeve
Tridhjetë e pesë (35)	Interpretime me shkrim (përmes arkivit të KRPP-së)
Treqind e gjashtëdhjetë e tetë (368)	Interpretime përmes adresës elektronike
Një mijë e shtatëdhjetë e tri (1073)	Interpretime përmes telefonit

Gjithashtu KRPP-ja gjatë vitit 2013 ka përgatitur dhe shpallur tri Udhëzime Administrative të cilat kanë hyrë në fuqi më 08 Janar 2014:

1. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 1/2014

Për përgatitjen e Specifikave Teknike për Kontratat për Punë

2. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2014

Për Sigurinë e Tenderit, Sigurimin e Ekzekutimit dhe Aplikimin e kriterit përzgjedhës ekonomik dhe financiar.

3. UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 3/2014

Për Disponueshmërinë e mjeteve për udhëheqje të aktiviteteve të prokurimit

* * *

Departamenti i Trajnimeve në kuadër të KRPP-së në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Administratë Publike, gjatë vitit 2013, kanë organizuar trajnimin për zyrtarët e prokurimit të autoriteteve kontraktuese të Kosovës;

1. Trajnimi Bazik / Fillestar

2. Trajnimi i Avancuar

Trajnimi i nivelit Bazik ka filluar më 17.04.2013 deri 21.05.2013, i cili është ndjekur nga 88 pjesëmarrës, të cilët kanë përcjellur 15 module të trajnimit bazik. Testi për nivelin Bazik është organizuar me 27.06.2013, nga Instituti Kosovar për Administratë Publike. Të gjithë vijuesit e trajnimit me sukses e kanë përfunduar testin dhe janë pajisur me Certifikatën themelore për prokurim publik, të vlefshme për tri vite.

Trajnimi i nivelit të Avancuar për prokurim publik sipas kërkesave të ligjit Nr. 04/L-042, për vitin 2013, ka filluar të mbahen më 27.05.2013 dhe ka përfunduar me 30.10.2013. Në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth 560 zyrtarë të prokurimit nga të gjitha autoritetet kontraktuese të Kosovës, të cilët paraprakisht e kanë përfunduar trajnimin Bazik për prokurim publik.

Testi përfundimtar për trajnimin e avancuar është mbajtur më 07.12.2013 nga Institutin Kosovar për Administratë Publike, kurse Ri-testi me 01. 02.2014. Nga 576 pjesëmarrës të ftuar për test, në të dy afatet 428 zyrtarë të prokurimit me sukses e kanë përfunduar testin.

Departamenti i Trajnimeve i KRPP-së në bashkëpunim me Commercial Law Development Program (CLDP) - Departamenti i Tregtisë së SHBA, dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Kosovë me 06 dhe 07 Qershor 2013, kanë mbajtur një trajnim të përbashkët mbi praktikën më të mira ndërkombëtare të prokurimit. Në këtë trajnim janë krahasuar praktikën e prokurimit të Shteteve të Bashkuara dhe të Kosovës. Trajnimin e kanë vijuar rreth 45 pjesëmarrës nga autoritetet kontraktuese të Kosovës, dhe se ky trajnim është vlerësuar ndër trajnimet më të frytshme të mbajtur gjatë vitit 2013, nga fusha e prokurimit publik.

* * *

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP –së kryen detyrat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve të prokurimit nëpër Autoritetet Kontraktuese duke u mbështetur në nenin 88.1 dhe 88.2 të LPP-së nr.04/L-042

Departamenti i monitorimit dhe mbikëqyrjes ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësinë të vëzhgoi, mbikëqyr dhe monitoroi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të këtij ligji.

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje gjatë vitit 2013 ka numruar gjithsej tetë (8) punëtor, Koordinatorin e departamentit dhe shtatë (7) ekspert të prokurimit, prej tyre katër për monitorimin e procedurave të prokurimit dhe tre punëtor për menagjimin e kontratave.

Planifikimi i monitorimeve të rregullta dhe realizimi i tij

Departamenti për monitorim dhe mbikqyrje për vitin 2013 ka paraparë monitorimin e tridhjet e dy(32) autoriteteve kontraktuese .

Departamenti për monitorim dhe mbikqyrje ka realizuar 100 %,planifikimin e paraparë pasi që gjatë vitit kalendarik 2013 ka monitoruar tridhjet e dy (32) nga tridhjet e dy (32) autoritetet kontraktuese të planifikuara,me gjithsejt 201 aktivitete të prokurimit

Autoritetet Kontraktuese të monitoruara gjatë vitit 2013 nga Departamenti për Monitorim dhe Mbikëqyrje

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik				
Departamenti për Monitorim dhe Mbikqyrje- Planifikimi vjetor për vitin 2013				
NR	Autoriteti Kontraktues	Koha e menduar për monitorim	Data e fillimit dhe mbarimit të monitorimit	Lloji I Monitorimit
1	KK Gjilan	Shkurt	21.02-27.02.2013	sipas planit
2	KK Drenas	mars	14.03-22.03.2013	sipas planit
3	RTK	mars	12.04-18.04.2013	sipas planit
4	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	prill	25.04-07.05.2013	sipas planit
5	KK Podujevë	maj	14.05-18.05.2013	sipas planit
6	Kompania Regjionale e ujitjes"Radoniqi &Dugagjini" Gjakovë	maj-qershor	29.05-04.06.2013	sipas planit
7	Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale -MPMS	qershor	12.06-18.06.2013	sipas planit
8	Spitali rajonal Pejë	qershor-korrik	28.06-05.07.2013	sipas planit
9	KK Viti	korrik	09.07-16.07.2013	sipas planit
10	Spitali Rajonal -Prizren	korrik	16.07-23.07.2013	sipas planit
11	Spitali "Sheik Zajed" Vushtrri	korrik	23.07-31.07.2013	sipas planit
12	Shërbimi profesional i shëndetit mendor- Prishtinë	gusht	05.08-13.08.2013	sipas planit
13	KOST	gusht	19.08-	sipas planit

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

			23.08.2013	
14	Qendra e transfuzionit të gjakut	gusht	26.08-29.08.2013	sipas planit
15	KK Deqan	shtator	02.09-06.09.2013	sipas planit
16	Ministria e Drejtësisë	shtator	09.09-13.09.2013	sipas planit
17	Agjensioni Kosovar kundër Korrupsionit	shtator	18.09-23.09.2013	sipas planit
18	Ministria e Diasporës	shtator	24.09-27.09.2013	sipas planit
19	AKP- Agjensioni Kosovar i Pronave	tetor	30.09-04.10.2013	sipas planit
20	Komisioni I pavarur për miniera dhe minerale	tetor	30.09-04.10.2013	sipas planit
21	KK Junik	tetor	07.10-14.10.2013	sipas planit
22	KK Hani I Elezit	tetor	18.10-24.10.2013	sipas planit
23	Qendra e studentëve	tetor	28.10-31.10.2013	sipas planit
24	Ministria e Financave	nëntor	04.11-08.11.2013	sipas planit
25	Univerziteti I Prishtinës	nëntor	12.11-18.11.2012	sipas planit
26	Zyra e rregullatorit për ujë dhe mbeturina	nëntor	19.11-22.11.2013	sipas planit
27	Akademia e shkencave dhe arteve të Kosovës	nëntor	20.11-25.11.2013	sipas planit
28	Komisioni për ndihmë juridike	nëntor-dhjetor	29.11-02.12.2013	sipas planit
29	Qendra e intelegjencës financiare e Kosovës	dhjetor	02.12-04.12.2013	sipas planit
30	Ngrohtorja e qytetit në Gjakovë	dhjetor	04.12-05.12.2013	sipas planit
31	KK Malishevë	dhjetor	11.12-13.12.2013	sipas planit
32	KK Skenderaj	dhjetor	në proces	sipas planit

KRPP-Departamenti i Monitorimit dhe Mbikëqyrjes në vitin 2013 ka ushtruar Monitorimin e aktiviteteve të prokurimit sipas planifikimit dhe ka evidentuar këto mosrespektime- shkelje të neneve të LPP-së nr. 04/L-042 dhe legjislacionit dytësor si: rregulloreve të PP , Udhëzuesit Operativ të PP dhe Udhëzimeve Administrative.

Shkeljet-Mosrespektimet e LPP-së nr.04/L-042		
Neni 7.1.2.3	- Barazia në trajtim, jodiskriminim	-12
Neni 8	- Planifikimi i prokurimit	22

Raporti mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2013

Neni 9.2	- Zotimi i mjeteve (pas nënshkrimit të kontratës)	-31
Neni 9.5	- Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve	06
Neni 9.6	- Deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve e dorëzuar në AQP	08
Neni 17.1	-Llog.e vlerës së parashikuar të kontratës për furnizim/shërbime	03
Neni 22	- Inicimi I aktivitetit të prokurimit	01
Neni 26	- Nënshkrimi i kontratës me çmim më të ulët se çmimi I publikuar në njoftimin për dhënie të kontratës dhe çmimi që figuron në raportin e vlerësimit	01
Neni 26.2	- Nënshkrimi i kontratës (kontrata nuk është nënshkruar nga ZKA)	04
Neni 26.2	- Konfirmimi I informatë se të dhënat në deklaraten e nevojave janë të sakta	08
Neni 28.1	- vlefshmëria e tenderit	03
Neni 28.2	- Specifikimi teknik	13
Neni 32.4	- Rregullat e përgjithshme (janë pranuar më pak se dy tender të përgjegjshëm)	04 01
Neni 35.2.4	- njoftimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në KRPP (punë shtesë)	02
Neni 36.6	- Afati i tenderimit për kuotim çmimi	02
Neni 36.7	- tri kuotime të përgjegjshme	01
Neni 38.2	- Kohzgjatja e kontratës	01
Neni 42.2	- Njoftim për dhënie të kontratës në uebfaqen e KRPP-së	17
Neni 44.2	- Afatet kohore për pranimin e tenderëve	06
Neni 46.2	Rregullat e posaçme për mundësinë e shkuritmit të afatit kohor	04
Neni 51.1	- Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes	06
Neni 52.1	- Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës	01
Neni 54.1	- Njoftimi itenderuesve të eliminuar	40
Neni 58.3	-Procesverbali I hapjes I pa nënshkruar nga zyrtari i prokurimit	10
Neni 59.2	- Ekzaminimi, vlerësim dhe krahasimi i tenderëve (kërkesa e dokumentacionit shtesë nga AK pas hapjes publike	01
Neni 59.3	- Ekzaminimi, vlerësim dhe krahasimi i tenderëve (njoftimi I OE për ërmirsimin e gabimeve aritmetike)	01
Neni 59.4	- Ekzaminimi, vlerësim dhe krahasimi i tenderëve	12
Neni 62.2	- Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit	01
Neni 63	- Sigurimi I ekzekutimit	12
Neni 63.2	- Kërkesat në dosjen e tenderit ndryshojnë nga kërkesat e publikuara në njoftimin për kontratë	01
Neni 63.3	- Sigurimi iekzekutimit pas nënshkrimit të kontratës	07
Neni 69.5.2	- Kriteret e përzgjedhjes	01
Neni 91	-Masat zbatuese (formularët stndard të aprovuar nga KRPP)	38
Shkeljet-Mosrespektimet e Rregullores së prokurimit publik		
Neni 9.1.5	- Prezantimi i dëshmime të kërkuara të përshtatshmërisë vetëm për fituesin (OE të propozuar për nënshkrimin e kontratës)	50
Neni 16.2.1	- Deklarata nën betim të komisionit vlerësues	03
Neni 16.2.1	- përgatitja e rekomandimit për zyrtarin e prokurimit	03
Neni 17.4	- Vlerësimi i ofertave pas 96 orëve nga hapja publike	06

Neni 26	- Përcaktimi i sasisë së përafërt	03
Shkeljet-Mosrespektimet e Udhëzuesi operativ i PP		
Neni 12.10	- Specifikimi në dosjën e tenderit për mundësinë vazhdimit të kontratës	04
Neni 17.8	- dokumentet me pagesë	01 01
Neni 26.4	- vlera e sigurimit të tenderit	05
Neni 28.2	- Validiteti I ofertës	01
Neni 28.3	- Nënshkrimi I kontratës pas kalimit të validitetit të ofertës	01
Neni 31.2	- vendimi i komisionit për hapjen e ofertave	08
Neni 31.4	- Njoftimi i OE konkurses për ndërprerjen e procedures së prokurimit	01
Neni 34.2	- Formimi I komisionit vlerësues prej rarti në rast	02
Neni 38.2	- Njoftimi për ndërprerjen e procedures së prokurimit në vebfaqen e KRPP-së	01
Neni 53.1b	- Kontrata për shërbime të konsulencës (shërbimet për konsulencë janë klasifikuar si hërbime të përgjithshme	01

Nenet të cilat kanë pasur numrin më të madhë të mosrespektimeve të monitoruara të LPP-së nr.04/L-042 , gjatë vitit 2013 janë:

Neni 54.1-Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesëve të eliminuar në 40 raste apo 13.98 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara


Neni 91.1- Masat zbatuese-Përdorimi i formularëve standard të zyrtarizuar nga KRPP në 38 raste apo 13.28 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara

Neni 9.2 – Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës në 31 raste apo 10.83 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara

Neni 8.1 – Planifikimi përfundimtar i prokurimit në 22 raste apo 7.69 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara

Neni 28.2- Specifikimi teknik në 13 raste apo 4.54 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara, , e kështu me radhë

Të gjitha shkeljet e tjera të evidentuara 49.30 % të totalit të shkeljeve – mosrespektimeve të evidentuara



Monitorimet sipas rastit - kërkesës

Poashtu departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje gjatë vitit 2013 ka realizuar monitorimin e katër (4) AK me gjithsejt njëmbëdhjet (11) aktivitete të prokurimit, sipas rastit – kërkesës së AK apo Operatorëve Ekonomik.

- 1- Ministria e Punëve të Brendshme - aktiviteti i prokurimit:
”Monitorimi i kontratave të MPB-së me kontraktorët privat për mirëmbajtjen e programeve të Teknologjisë Informative të kontraktuara nga MPB-ja”
- 2- Policia e Kosovës - aktivitetet e prokurimit:
 - Mirëmbajtja e Sistemit 911-ritender
 - Ndërtimi i N.S.P Mushtisht dhe ndërtimi i S.P.Ranillug
 - Furnizimi me tonerë
 - Ndërtimi i objektit të drejtorisë rajonale në Mitrovicë
 - Servisimi, furnizimi me pjesë dhe vajra për automjetet e PK-së
 - Furnizimi me këpucë dhe çizme për PK-ritender Lot 1
 - Furnizimi me material shpenzues për laborator te PK-se
 - Mirëmbajtja ,servisimi dhe kalibrimi i pajisjeve për kontrollimin e dokumentacionit identifikues VSC 6000
- 3- “Trepça”sha - aktiviteti i prokurimit:

“Furnizim me material administrativ”

- 4- AK “Kostt”Sha – sipas kërkesës së OE”MONTEN & G3 Inxhiniering” aktiviteti i prokurimit: ”Instalimi i TR2 në NS 110/10 (20)-Skenderaj”

Monitorimi i dosjeve të tenderit sipas kërkesës së AK dhe OE si dhe palëve të interesuara	
1	Monitorimi i dosjes sioas kërkesës së Univerziteti i Prishtinës I dt 25.01.2013
2	Monitorimi i përmbajtjes së Kontratës të AK- KK Prishtinë sioas kërkesës së OE NNP"CTA"
3	Monitorim i kërkesave në dosjen e tenderit të AK -MASHT sipas kërkesës së Arsim Robelli - Level_nsht@yahoo.com
4	Përgjigje në kërkesën për interpretim të AK KK-Prishtinë
5	Monitorim I dosjes së tenderit të MMPH sipas kërkesës së Shensi Luta@delfin-auto.com
6	Përgjigje në kërkesën për interpretim të "generalgroup.prishtina@gmail.com
7	Intervenim për përmirsimin e kriterëve në dosjen e tenderit për Aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të UP-së"
8	Përgjigje në ankesën për shkelje të ligjit të LPP-së nga AK KOSTT.sha sipas kërkesës së OE"Rojet e nderit "Shpk
9	Përmirsimi I kërkesave në dosjen e tenderit të aktivitetit të prokurimit" Pastrimi i hapsirave të bre dhe të jashtme në UP" sipas kërkesës së Afrim Bajraktarit
10	Përgjigje në kërkesën për opinion nr.108/2013 të Arben Spahiu-ud.zyrtar i auditimit të brenshëm KEK
11	Monitorimi I dosjes së tenderit të AK -AUV "Shërbimi I sigurimit fizik të Objektivit të AUV"
12	Monitorimi i Dosjesse tenderit sipas kerkeses "ALPHA PRIVATE SECURITY COMPANY"
13	Opinion sipas kerkeses se "Leonora.G.@Europrinty.net
14	Pergjigje ne kerkesen e "Bajram Kolgeci @hotmail.com dhe mailto .info@SFK.security.com per permisimin e kriterëve ne dosjen e tenderit.
15	Permisimi i kerkesave te Njoftimit per Kontrate te Aktivitetit te Prokurimit "Sigurimi Fizik I Objekteve te Komunes se Gjakoves" sipas kerkeses se :top securuty @outlook.com
16	Permisimi i kerkesave ne dosjen e tenderit"Furnizimi blerja e Fidaneve per ngritjeve e pemishteve"K.K.Istog"
17	Permisimi i kerkesave ne dosjen e tenderit te aktivitetit te Prokurimit"Renovimi i Fakultetit te Edukimit" sipas kerkeses se OE N.T.P.Anita.com
18	Pergjigje ne kerkesen ne Rishqyrtimin te interpretimit te leshuar nga Autoriteti Kontraktues , UPZ.
19	Pergjigje ne kerkesen e Z.Hasan Gashi lidhur me permismen e kerkesave ne dosjen e tenderit per aktivitetin e prokurimit "Renovimi i fakultetit te Edukimit"
20	Monitorimi Dosjes se tenderit te Autoriteti Kontraktues Univerziteti i Prishtines per Aktivitetine Prokurimit"Pastrimi I Hapsirave te mbrendshme dhe te jashtme te Objektivit te Univerzitetit te Prishtines sipas kerkeses se OE b.kosova@hotmail.com
21	Kërkes për sqarim të kërkesës për monitorim të dosjes së tenderit nga OE "esp.npsh@gmail.com

Monitorimi i menaxhimit të kontratave
Autoritetet Kontraktuese të monitoruara gjatë vitit 2013
nga Departamenti i Monitorimit të Menaxhimit të Kontratave
Publike

Departamenti për Monitorimin e Menaxhimit të Kontratave Publike gjatë vitit 2013, ka monitoruar 20 autoritete kontraktuese me gjithsej 35 kontrata publike, të cilat do ti paraqesim në vazhdim:

NR	Autoriteti Kontraktues	Monitorimet e realizuara më:	Lloji i Monitorimit	Shklejet e evidentuara	Vërejtjet për AK
1	KK - Podujevë	Maj	sipas planit	0	5
2	Spitali rajonal Pejë	Qershor	sipas planit	4	3
3	KK - Viti	Korrik	sipas planit	2	4
4	Spitali Rajonal -Prizren	Korrik	sipas planit	7	2
5	Spitali - Vushtrri	Gusht	sipas planit	2	0
6	KOSTT	Gusht	sipas planit	2	1
7	Ministria e Diasporës	Shtator	sipas planit	0	1
8	Agjencia Kosovare e Pronës	Tetor	sipas planit	1	1
9	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	Tetor	sipas planit	1	0
10	KK - Junik	Tetor	sipas planit	1	2
11	Qendra e Studentëve	Nëntor	sipas planit	3	1
12	Ministria e Financës	Nëntor	sipas planit	5	4
13	Universiteti i Prishtinës	Nëntor	sipas planit	7	1
14	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim	Nëntor	sipas planit	2	1
15	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	Nëntor	sipas planit	7	2
16	Agjencioni për Ndihmë Juridike	Nëntor	sipas planit	4	1
17	Njësia e Intelegjencës Financiare	Dhjetor	sipas planit	2	0
18	Ngrohja e Qytetit - Gjakovë	Dhjetor	sipas planit	8	2
19	KK Malishevë	Dhjetor	sipas planit	5	4
20	KK Skenderaj	Dhjetor	sipas planit	1	0

KRPP - Departamenti i monitorimit të menaxhimit të kontratës publike në vitin 2013 ka bërë monitorimin e kontratave të menaxhuara nga ana e autoriteteve kontraktuese sipas planifikimit që ka pas Departamenti për Monitorim dhe Mbikqyrje, dhe gjatë këtyre monitorimeve ka evidentuar këto mosrespektime- shkelje të neneve të LPP-së Nr.04/L-042, dhe legjislacionit dytësor si: rregulloreve të PP , Udhëzuesit Operativ të PP dhe Udhëzimeve Administrative.

Shkeljet-Mosrespektimet e LPP-së nr.04/L-042

Neni 10.2	Kompletimi i dokumentacionit	1
Neni 17.6	Ndarja e kërkesave	1
Neni 35	Procedura e Negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	2
Neni 38	Kontrata Publike Kornizë	3
Neni 63	Siguria e Ekzekutimit	2
Neni 81	Aktivitetet e Menaxhimit të Kontratës	13
Neni 91	Masat Zbatuese	4

Shkeljet-Mosrespektimet e Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik

Neni 12.10	Zgjatja e periudhës së Ekzekutimit	2
Neni 15	Numri i Prokurimit	1
Neni 55.4	Bartje e përgjegjësisë tek Menaxheri i Projektit	10
Neni 55.8	Përgatitja e PMK nga Menaxheri i Projektit	8
Neni 56.3	Ndarja e Punëve	3


Shkeljet-Mosrespektimet e Kontratave

Neni 4	Vonesa në Pagesa	6
Neni 26	Çertifikata për furnizuesin	4
Neni 15	Mos vërtetimi i cilësisë nga Menagjeri i Projektit	1
Neni 8 gjegjësisht neni 16	Dëmet e likuiduara	4

Nenet të cilat kanë pasur numrin më të madhë të shkelje të evidentuara për vitin 2013:

Neni 81 - Aktivitetet e Menaxhimit të Kontratës, 13 raste apo 20% të shkeljeve të evidentuara në 35 kontrata të monitoruara,
Neni 55.4 - Bartje e përgjegjësisë tek Menaxheri i Projektit, 10 raste apo 15% të shkeljeve të evidentuara në 35 kontrata të monitoruara,
Neni 55.8 - Përgatitja e PMK nga Menaxheri i Projektit, 8 raste apo 12.30% të shkeljeve të evidentuara në 35 kontrata të monitoruara,
Neni 4 - Vonesa në Pagesa, 6 raste apo 9.23% të shkeljeve të evidentuara në 35 kontrata të monitoruara.

Paraqitja e rasteve të evidentuara të shkeljeve të neneve përmes grafikonit



Në vitin 2012 kemi pasur këtë gjendje:

Nenet të cilat kanë pasur numrin më të madhë të mosrespektimeve të monitoruara të LPP-së nr.03/L-241 dhe 04/L-042 gjatë vitit 2012 janë:

Neni 9.2 –Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës në 23 raste apo 15.23% të aktiviteteve të prokurimit të monitoruara


Neni 54.1- Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesëve të eliminuar në 22 raste apo 14.57 % të aktiviteteve të prokurimit të monitoruara

Neni 9.5 – Deklarata e nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve në 16 raste apo 10.59% të aktiviteteve të prokurimit të monitoruara

Neni 8.1 –Planifikimi i prokurimit në 16 raste apo 10.59%

Neni 91.1 - Përdorimi i formularëve standard të zyrtarizuar nga KRPP 08 raste apo 5.29% etj

Të gjitha shkeljet e neneve tjera të evidentuara janë 43.73 % të rasteve të evidentuara



Nëse tërheqim një paralele mes raportit të shkeljeve - mosrespektimeve të dy viteve kalendarike 2012 dhe 2013 atëher do të shohim se kemi gjendje të njëjtë , sa i përket numrit të shkeljeve pasi që kemi një ngritje të numrit të shkeljeve në raportet e monitoruara gjatë vitit 2013 mirëpo këtu nuk mund të bëjmë një krahasim real pasi që kjo ka ndodhë edhe për shkak të numrit të ndryshëm të AK të monitoruara.

Në vitin 2012 sipas planifikimit kemi monitoruar 24 Autoritete kontraktuese me 151 aktivitete të prokurimit ndërsa në vitin 2013 janë monitoruar tridhjet e dy (32) autoritetet kontraktuese të planifikuara, me gjithsejt 201 aktivitete të prokurimit, prandaj nëse krahasojmë numrin e aktiviteteve të prokurimit të monitoruara në vitin 2012 dhe numrin e aktiviteteve të prokurimit të monitoruara në vitin 2013 atëher përqindja e shkeljeve të evidentuara në dy vitet e krahasuara është përafërsisht I njëjtë.

Në vazhdim do të paraqesim krahasimin e disa neneve në dy vitet e fundit (vitit 2012 dhe vitit 2013)

	Viti 2012	Viti 2013
Neni 9.2 - Zotimi i mjeteve pas nënshkrimit të kontratës në	23 raste	31 raste
Neni 54.1- Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesëve të eliminuar në	22 raste	40 raste
Neni 91.1- Përdorimi i formularëve standard të zyrtarizuar nga KRPP	08 raste	38 raste

Në departamentin e monitorimit gjithashtu është caktuar zyrtari përgjegjës i cili përcjell njoftimet e autoriteteve kontraktuese për këto tri procedura të prokurimit si në vijim:

- Revokimi i nenit 32 ,më pak se dy (2) operator ekonomik të përgjegjshëm në 171 raste
- Neni 35 –Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimeve për kontratë është shfrytëzuar në 452 raste
- Neni 61-Tenderët jonormalisht të ulët janë evidentuar në 22 raste

Të gjitha këto procedura të dërguara(evidentuara) nga autoritetet kontraktuese, ka edhe aktivitete të cilat autoritetet kontraktuese kanë hequr dorë nga përdorimi i tyre pas njoftimit në KRPP, që do të thotë jo të gjitha njoftimet të cilat janë dërguar në KRPP edhe janë ekzekutuar.

Vëzhgimi i procesit të hapjeve dhe Vlerësimeve publike të aktiviteteve të prokurimit

Departamenti për monitorim dhe mbikqyrje gjatë vitit 2013 ka marr pjesë në një rastë në cilësinë e vëzhguesit, në hapje publike në:

1. Ministria e Drejtësisë , aktiviteti i prokurimit:

“Furnizim me toner për nevojat e Ministrisë ” inicuar nga Ministria e Drejtësisë

Dhe një rast në cilësinë e vëzhguesit në vlerësimin e ofertave:

1. Vëzhgimii i procesit të vlerësimit të AK- Akademia e Kosovës për siguri publike për aktivitetin e prokurimit:”Ndërtimi I konviktit të ri” (konvikti I studentëve I kategoris së lartë të AKSP-së)

KORIGJIMI I NJOFTIMEVE PËR KONTRATË, NJOFTIM PËR DHËNJE KONTRATE TË DËRGUARA PËR PUBLIKIM NË WEB FAQEN E KRPP-SË GJATË VITIT 2013 (MBI 620 NJOFTIME TË KORIGJUARA)		
	Parregullësit e evidentuara	Komente/Rekomandimet
1	Mospërputhje e versioneve gjuhësore të njoftimeve	Në shumë raste kemi mosperputhje te versioneve gjuhësore te njoftimeve, si datat, kodet e prokurimit, lloji i prokurimit, vlera e prokurimit, procedura apo ndojë gabim në perkthim i tekstit, pra te gjitha keto raste eshte dashur te kontaktohet me zyrtarin e AK dhe të permisohen.
2	Mosdërgimi i versioneve në të gjitha gjuhët që kërkohet	Shpesh nuk dergohen verzionet në anglisht kur është vlerë e madhe.
3	Dërgimi i verzionit të njoftimit joadekuat	Pra dergohen njoftime të formave të vjetra, apo sipas ligjit të PP që sështë në fuqi.
4	Kerkimi i dokumentave që skërkohen për të gjithë OE	Kërkimi i vertetimeve nga gjykata apo ATK për të gjithë OE, me legjislacioni dytësor të LPP 04/L-042, këta dokumente kërkohen vetem nga OE që propozohet për dhënje kontrate.
5	Kerkimi i dokumentave nga OE original apo të notarizuar	Si kërkimi i kontratave si dëshmi për referenca, original apo të notarizuara.
6	Kërkesat e përshtatëshmeris jo të plota	Shpeshë kemi hasur që një pjesë e kërkesave nuk shenohen në njoftim kontrate dhe në vend të tyre kemi “Referoju dosjes së tenderit”.
7	Te kushtet për pjesmarrje kapaciteti ekonomik-financiar	Kerkohet vlera e kontratave të realizuara ma tepër se qështë e nevojshme, duke kaluar trefishin dhe mëtepër të parallogaris së projektit.
8	Kriteret për dhënje kontrate: Çmim ekonomikisht më i favorshem, nënkriteret e përdorura	Pjesa e nën kriterëve për dhënje kontrate , sipas çmimit ekonomikisht më të favorshem ka qen një sfidë për KRPP-në edhe gjatë vitit të kaluar , me mjaft angazhim kemi arritur ti zvoglojm nënkriteret e pamatshme të cilat i kan vendosur AK . Dhe mund të kostatojm se përdorimi i kritererit për dhënje kontrate; Çmimi ekonomikisht më i favorshem është zvogluar dukshem, gjatë vitit 2011 pjesmarrja e këtij kriteri në vleren e kotratave të nënshkruara ishte 15,46% kurse gjatë vitit 2012 në 9,53%, dhe gjatë vitit 2013 zbret në 2.39%.
9	Dokumentet me pagesë	Ende ka vazhduar një pjes e AK të kërkojn pagesa për terhejken e DT, edhe pse vrehet se natyra e projektit nukë është e ndërlikuar dhe sidomos kurë është vëerë e mesme, pasi që në shumicen e rasteve DT mund të ju dergohet OE në formë elektronike, dhe nukë krijojn asnjë shpenzim.
10	Afati kohor për dorëzimin e	Shpesh afatet kohore shkurtohen më tepër se që

	tenderve i shkurtuar:	lejon LPP, dhe duke mos dhën arsyetim për shkurtim afati.
11	Siguria e tenderit	Në shume raste kur kerkohet Siguria e tenderit AK vendosin %, pra kerkohet vlera e siguris së tenderit, e jo e shprehur ne%.
12	Gabime në data	Data e hapjes së tenderit ditë vikendi, apo mosperputhje të verzioneve gjuhësore.
13	Mosevidentimi si Ri-Tenderim	Shpesh ndodhë që njoftimet e derguara të mos jenë evidentuar kuart si Ri-tender , ndonjëher shenohet ne permbajtje te emailit, në pjesën e titullit të projektit apo harrohet për tu evidentuar si Ri-tender.
14	Te njoftimi per dhënje të kontratës, mungojn datat dhe numri i tenderve të pranuar	Si psh. Mungon data e dhënjes së kontratës, data e planifikuar e nënshkrimit të kontratës, si dhe numri i tenderve të pranuar.
15	Shenimet jo të plota për OE të propozuara për kontratë	Te njoftimet për dhënje kontrate , informacionet për OE nuk janë të plota, dhe shpeshë shkurohet emertimi i OE, mungon emri i përsoneit kontaktues apo emaili. Edhe përkundër angazhimit për përmisim, prap ndodhë që emeritimi i OE te jetë me gabime, e që ne si KRPP nuk kemi mundesi ta dim se kur është shenura gabimisht. Andaj propozojm që në të ardhmën, në këtë pjes të informacioneve të shtohet edhe numri i regjistrimit të biznesit, e vetëm atëher do të jemi të sigurt se për cilin OE bëhet falë.
16	Informacione jo të plota mbi vlerën e kontratës	Në shumë raste, sidomos kur kemi të bëjm me çmim për njësi, mungon vlera e përgjithshme e kontratës
17	Raporti i kontratave të nënshkruara gjatë vitit	Gjithashtu edhe te këto raporte ka pas mangsi në shenime, si vendosja e çmimeve për njësi në vend të çmimit të përgjithshem të kontratës, mosplotsimi i vlerës së planifikuar, mosevidentimi i kodeve drejt sipas procedures së përdorur etj.

* * *

Me qëllim të përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, KRPP-ja gjatë vitit 2013, në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm ka filluar implementimin e disa projekteve:

1. Projekti për Përmirësimin i Kapaciteteve Administrative në fushën e Prokurimit Publik në Kosovë.- Ky projekt financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, i cili ka filluar të implementohet në Dhjetor të vitit 2012, kurse parashihet të zgajë 30 muaj – deri në Qershor 2015;
2. Projekti për zhvillimin e platformës së prokurimit elektronik në Kosovë.- Ky projekt financohet nga Banka Botërore. Njoftimi për këtë kontratë është shpallur nga Banka Botërore me 03 Shkurt 2014, kurse përfundimi i tij pritet në Mars 2015;
3. Projekti për Matjen e Pajtuëshmërisë dhe Monitorimi i Performancës së Entiteteve dhe Stafit të Prokurimit në pajtim me Sistemin e Prokurimit Publik në Kosovë.- Projekti financohet nga Banka Botërore, dhe ka filluar të implementohet në Nëntor të vitit 2013, kurse parashihet të zgajë 24 muaj – deri në Tetor 2015;
4. Projekti për Përgatitjen e Manualit për Çmimet për njësi për punë, mallra dhe shërbime.- Edhe ky Projekt financohet nga Banka Botërore, dhe ka filluar të implementohet në Nëntor të vitit 2013, kurse parashihet të zgajë 24 muaj – deri në Tetor 2015;

4. PËRMBYLLJE DHE REKOMANDIME

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport mbi kontratat e nënshkruara publike të prokurimit publik, të zhvilluar gjatë vitit 2013 dhe duke krahasuar me periudhat paraprake mund të konstatohet një përparim në fushën e prokurimit publik në Kosovë.

Ndër treguesit më të mirë të rezultateve të arritura të përmirësimit të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi janë ndryshimi i LPP dhe harmonizimi me Direktivat e BE-së, rritja e përdorimit të procedurës së hapur në prokurim publik, zvoglimi i përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, derisa te AK Qeveritare kemi zvoglim të vazhdueshëm të kësaj procedure krahasuar me vitet paraprake, gjatë vitit 2013 edhe te Kompanit Publike kemi një rënje të theksuar të përdorimit të kësaj procedure.

Gjithashtu gjatë vitit 2013 KRPP ka përgatit tri udhëzime administrative, të cilat kanë hyrë në fuqi gjatë janarit të vitit 2014, të cilat e kanë ndihmuar funksionimin e prokurimit publik.

Ndër treguesit më të rëndësishëm që pasqyrojnë trendin e zhvillimit të prokurimit publik janë:

- Rritja e pjesëmarrjes së vlerës së kontratave të nënshkruara për punë, e që gjatë vitit 2011 ishte 52,43%, derisa gjatë vitit 2012 kjo pjesëmarrje arrin në 60,50%, dhe në vitin 2013 është 71.85% në raport me furnizimet që ishin 21.11%, shërbimet 6.93% etj.
- Rritja e pjesëmarrjes së vlerës së kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur, e që gjatë vitit 2011 ishte 82,80%, gjatë vitit 2012 është 84,00%, derisa në vitin e fundit 2013 është 87.86%.
- Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë e cila gjatë vitit 2013 ishte 5.60%. Përdorimi i kësaj ka pasur një zvoglim të theksuar gjatë këtyre viteve, derisa në vitin 2008 ishte 19%, dhe 2009 ishte 11%, në vitin 2010 në 7%, dhe gjatë vitit 2011 zbritet në 6,21%. Ndërsa gjatë vitit 2012 te AK Qeveritare kjo pjesëmarrje zbritet në 6,07%, te Kompanit publike ishte 17,88%, derisa te të gjitha është 10,44%, dhe më në fund gjatë vitit 2013 te Kompanit publike zbritet në 10.05%, te AK Qeveritare kemi ulje në vazhdim e që ishte 4.44%, dhe në totalin e tyre kemi pra ulje të theksuar krahasuar me vitet paraprake e që është 5.60%.
- Tregues tjetër është edhe anulimi i njoftimeve për kontratë. Gjatë vitit 2010 anulimi i njoftimeve në raport me publikimin e njoftimeve për kontratë ishte 37%, derisa gjatë vitit 2011 ky numër i anulimeve është zvogluar në 34% dhe gjatë vitit 2012 ishte mesatarisht 33,40% dhe 35.40% gjatë vitit 2013.

- Zhvillimin dhe transparencën e prokurimit publik në Kosovë e tregon edhe pjesëmarrja e OE jovendor që kanë përfituar kontrata gjatë vitit 2013, e cila arrinë në 7.02% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara, dhe nëse vlerës së kontratave ja shtojm pjesmarrjen e “autostrades” për vitin 2013, atëher na del se pjesmarrja e kontratave të nënshkruara nga OE jovendor gjatë vitit 2013 është 36.92%.
- Numri mesatar i ofertuesve që kan konkuruar për një tender gjatë vitit 2011 në Kosovë ishte 5.1 derisa gjatë vitit 2012 numri mesatar i ofertuesve për një tender arrin 5.8 dhe gjatë vitit 2013 në 5.2 . Pra kemi një rritje të vazhdueshme të ofertuesve, qka e rritë konkurrencën.
- Pjesëmarrja e vëlerës së kontratave të nënshkruara në BPV gjatë vitit 2013 ishte 12.72%, e cila pjesmarrje përafërsisht e ka përcjell edhe vitet e kaluara.
- Pjesmarrja e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm gjatë vitit 2011 ishte 15,46% kurse gjatë vitit 2012 në 9,53%, dhe gjatë vitit 2013 zbret në 2.39%, pra siq po shihet kemi një zvoglim të dukëshem të përdorimit të nënkriterit për dhënie “çmimi ekonomikisht më i favorshëm” .
- Në ueb faqen e prokurimit publik të KRPP-së prej qershorit të vitit 2007 e deri në dhjetor 2013 janë publikuar mbi 77600 njoftime të gjitha llojeve. Gjatë vitit 2013 numri mesatar ditor i vizitorve të kësaj web faqe arrin mbi 8400. Kjo web faqe ka një rëndësi të pakontestueshme mbi transparencën me informacionet që ofron për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik mbi zhvillimin e prokurimeve publike në Kosovë.

Duke u bazuar në analizën e raportit mbi aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2013, në monitorimet dhe vëzhgimet e kryera, si dhe në komentet që i ka pranuar KRPP-ja nga autoritetet kontraktuese të Kosovës lidhur me mënyrën e implementimit të Ligjit për Prokurim Publik në praktikë, KRPP-ja rekomandon këto masa për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë :

- Reformimi i vazhdueshëm i sistemit të prokurimit publik në Kosovë, aftësimi i vazhdueshëm i zyrtarve të prokurimit publik.
- Të zvogëlohet sa është e mundur përdorimi i kontratave me vlera të vogla dhe minimale, duke shfrytëzuar marrëveshjet publike kornizë, si dhe prokurimet e centralizuara.
- Avancimi i mëtutjeshëm i ueb faqes zyrtare elektronike të prokurimit publik, që mundëson ngritjen e transparencës në prokurim publik dhe që promovonë një prokurim efikas, duke u bazuar në praktikat bashkëkohore të prokurimit dhe teknologjinë e re, siç janë prokurimi elektronik dhe ankandi elektronik.

5. ANEKSI : SHPENZIMET BUXHETORE TË KRPP-së PËR VITIN 2013

Për kryerjen e veprimtarisë së paraparë me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, gjatë vitit 2013, KRPP-ja ka shpenzuar shumën buxhetore prej 287,550.21€.

Tabela e shpenzimeve buxhetore të KRPP-së për vitin 2013

NR.	PËRSHKRIMI	BUXHETI I APROVUAR 2013 (€)	BUXHETI I PERFUNDUAR 2013 (€)	BUXHETI I SHPENZUAR 2013(€)	PJESMARRJA (%)
1	Pagat = (27 punëtorë)	179,859.00	179,859.00	168,673.48	93.78 %
2	Mallra & shërbime	127,306.00	127,306.00	109,410.28	85.94 %
3	Shpenzime komunale	20,200.00	12,200.00	9,466.45	77.59 %
4	Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	
	Gjithsej:	327,365.00	319,365.00	287,550.21	90.00%

Nga tabela e mësipërme shihet se buxheti përfundimtar për vitin 2013 në vlerë prej 319,365.00 € është shpenzuar në vlerë prej 287,550.21€, e shprehur në përqindje prej 90.00 % . Në pjesën e pashfrytëzuar të buxhetit ka ndikuar pjesa për paga, pra mos plotësimi i disa vendeve të lira të punës, si dhe kursimet e shpenzimeve në qira me transferimin në objekte qeveritare .

Nga pjesa e shpenzuar për mallra&shërbime , një specifikacion më i detaizuar shpenzimeve është dhënë në tabelën më poshtë :

EMËRTIMI I SHPENZIMEVE		SHUMA (€)
1	Shpenzimet e udhëtimit	7,227.06
2	Shërbimet e telekomunikimit (Vala)	12,360.00
3	Shpenzimet për shërbime(kontra,tjera)	11,142.41
4	Shërbimet arsi,&trajnimet(kurset-trajnimet)	3,429.00
5	Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	2,664.00
6	Paisje per IT (nën 1000 Euro)	5,507.50
7	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	7,890.62
8	Derivatet dhe lëndët djegëse	8,345.49
9	Shërbimet e shtypjes-jo marketing	1,055.00
10	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	2,162.00
11	Telefona(nën 1000Euro)	5,034.00
12	Mirëmbajtja e automjeteve	6,125.89
13	Mirëmbajtja e obj.	665.74
14	Qiraja	26,077.00
15	Shpenzimet e marketingut	249.98
16	Reprezentacion	3,897.55
17	Shpenzimet e publikimeve	0.00
18	Paisje tjera	2,904.04
19	Tatimi ne qira	2,673.00
20	Shpenzimet e kek-ut	5,801.94
21	Shpenzimet e ujit	549.69
22	Shpenzimet e ngrohjes qendrore	87.7
23	Shpenzimet e telefonis fikse	2,597.72
24	Shpenzimet e pastrimit	429.40
	Gjithsejtë :	118,876.73